# Gjergj Kokoshi (1904-1960)

Proceset ndaj organizatave politike opozitare në Shqipëri - Rasti Gjergj Kokoshi




SEKSIONI

Figura historike

PERIUDHA

1946 - 1946

Gjergj Kokoshi mbaroi studimet në në Itali dhe Francë dhe mbron titullin "Doktor në Letërsi". Me kthimin në Shqipëri përkrah lëvizjen antifashiste dhe në punimet e Kongresit të Përmetit zgjidhet anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacional-Çlirimtar, ku ngarkohet që në atë kohë të merrej me çështjen ne arsimit. Emërohet Ministër Arsimi, për 80 ditë dhe jep dorëheqjen për shkak të mospërputhjeve me politikat e kohës. Ajo që e shënjoi fatin e tij ishte reagimi ndal ligjit të ri elektoral të vitit 1945, i cili nuk garantonte zgjedhje të lira dhe pengonte krijimin e një opozite parlamentare. Në përpjekje me një grup intelektualësh të kohës dhe me orientimin e misioneve angleze dhe amerikane në vend, u mundua të përfshihej në krijimin e një grupi politik që mund të pengonte apo të shtynte zgjedhjet për shkak të kohës së kufizuar. Jo vetëm që nuk ia arritën të formalizonin një opozitë përballë Frontit Demokratik, por madje u arrestua si pjesë e një grupi prej 37 personash. Gjyqi filloi në filloi në 17 qershor dhe përfundoi më 2 korrik 1946 dhe u dënua me 30 vjet burgim. Vdes në burgun e Burrelin në vitin 1960.

PERMBAJTJE #1

# Dosja hetimore - gjyqësore nr. 1081 "Proceset origjinale të grupit fashist, terrorist i përbamë prej 37 personave me në krye Sami Celibashin, kryetar i Grupit të Rezistencës, Qenan Dibrën, etj., përfaqësues i Grupit Monarkist dhe Musine Kokalarin, kryetare e Grupit Social-Demokrat. Që të tre këto grupe së bashku kanë formue organizatën “Bashkimi Demokratik me në krye një komitet qendror të përkohshëm, i ashtuquajtur “Komiteti Nacional”"

Dosje e krijuar në vitin 1946 mbi hetimin, gjykimin dhe dënimin e 37 të akuzuarve, anëtarë të opozitës së parë shqiptare. Vëllimet përmbajnë dokumente të proceset të hetimit, deklarata, procesverbale, ballafaqime, mbrojtjen në gjyq, si dhe vendimet e ekzekutimeve apo dënimeve si dhe ridënimeve, tekstin e notës drejtuar misionit anglo-amerikan etj. Dokumentacioni mbi Gjergj Kokoshin është pjesë e dosjes së tretë të procesit të 37 personave të dënuar për krijimin e organizatës “Bashkimi demokrat” i cili kishte si qëllim krijimin e një opozite ndaj Frontit Demokratik në mënyrë që të përfaqësohej në zgjedhjet parlamentare dhe të krijonte një opozitë reale në Shqipëri.

MEDIA #1

# Procesverbal

MEDIA FAQE #1



Vdekje Fashizmit
Liri Popullit

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPRIS
GJYKATA E LARTË USHTARAKE
Tiranë

Nr. 5 i Librit Themelòr

96 flet

PROÇES-VERBAL

Prokurorija e kësaj Gjykate me akt-akuzën datë 10 Qershòr 1946 na deferon për gjykim, bashkë me aktet, të pandehurit: Gjergj Kokoshi, Suad Asllani, Sami Çeribashi, Qenan Dibra, Reiz Hasho, Kolë Rodhe, Lluka Bibi, Anton Dukagjini, Nesimi Starova, Hivzi Gole, Haki Gjinishi, Xhevat Miluka, Taqi Ruço, Haki Karahoxha, Ali Kavaja, Muzine Kokalari, Hasan Kalaja, Shaban Balla, Musa Dizdari, Enver Hasa, Mefail Skikuli, Qemal Biçaku, Pali Terova, Myrteza Beli, Nesti Orollogaj, Samiraz Vërlaci, Mehmet Alibeshiri, Profi Çoka, Xhahit Koka, Mahmut (Tut) Mniku, Pierin Shala, Vahid Vërdolla, Llazar Papapostòli, Niko Beça, Talat Drini, Stefan Bumçi, Abdullah Muça, që të gjithë t'akuzuar sepse janë organizuar në grupe klandestine për të përmbysur pushtetin demokratik në lidhje me kriminelat e luftës n'arrati dhe me reaksionin e jashtëm; kanë kryer dhe kanë tentuar të kryejnë vrasje kundra njerëzve dhe funksionarëve të pushtetit popullòr sidhe akte të tjera sabotazhi; u kanë dhënë informata ushtarake, politike dhe ekonomike të huajve, etj.etj., duke vepruar kështu kundra interesave të larta t'Atdheut e të popullit.

Aktet u regjistruan nën Nr.5 të Librit Themelòr të pàdinave penale të këtij vjeti dhe për ditë gjykimi të çështjes u caktua data 17 Qershòr 1946, ora 8, duke iu njoftuar të pandehurve të sipërpërmëndur që ndodhen t'arrestuar.

Tiranë, më 15 Qershòr 1946

Sekretari:
Aspirant (Thoma Rino)

Kryetari:
Major (Fredrik Nosi)

Sot, ditën dhe orën e caktuar, Trupi Gjykues i mbledhur në sallën e Kinemas "Nasional" të Tiranës, u formua nga:

Major Fredrik Nosi Kryetar,
Kapiten I-rë Veledin Zejneli Anëtar,
" Nexhat Hysejni "

Procesverbal

INFORMACION

## Procesverbal

Autoret: Trupi Gjykues:major Frederik Nosi, kryetar; kap. I Veledin Zejneli dhe Nexhat Hysejni, anëtarë

| | |
|---|---|
| FONDI | 1 |
| DOSJA | Nr. 1081 |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Hetimore-gjyqësore |
| STRUKTURA | Gjykata e Lartë Ushtarake |
| LIDHJA | Musine Kokalari |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | KInema "Nacional", Tiranë |
| GJUHA | shqip |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

# Aktakuzë

MEDIA FAQE #1



Model 656

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
PROKURORIJA E GJYKATES USHTARAKE
TE NALTE

Nr. 5 Regj. Them.

**AKT - AKUZE**
(KOMUNIKATE)

**GJYKATES USHTARAKE**

Sikurse do të konstatohet dhe nga proces-verbalet e mbajtura prej Seksionit te M.P. te Tiranes, që bashkangjitur paraqiten, i pandehuri GJERGJE KOKOSHI i biri Jaçim dhe i Viktores, vjeç 42, nga Shkodra me profesion ose efektiv Prefesor i rreshtuar më datën 23.Janar.1946. akuzohet se I pandehuri bashkepunuar me Suat Asllanin, Qenan Dibren, Sami Çeribashin dhe elementa te tjere, te ballit, legalitetit, e tjere.-

2) Ka udhezuar dhe frymzuar keta ne menyren e veprimit per te ter hequr sa me shume elementa duke i meshtruar e duke i premtuar ndihma te reaksionit te jashtem.-

3) Ju ka treguar menyra organizimi ne krijime grupesh, te cilet te lidheshin nder mjet njeri tjetrit; i rezistences, i monarkistave, e tjere, te lidheshin gjitheashtu me gjith t'aratiaurit kriminela lufte mbrenda e jashte Shqiprise.-

4) I ka mesuar te perpillojne nota (kerkesa) per Misionin e huaj dhe me anen e ketyre t'a paraqitninsi te turbullketu, duke kerkuar nderhy-RJEN e ndihmeve te tyre.-

5) Ka shfrytzuar vendin, emrindhe kredine qe i kishte dhene Fronti duke e perdorur per te sabotuar e per te permbyse Pushtetin.-

6) Gjith aktiviteti e propoganda e tij ka qene per te, per per- të përmbysur me forcë pushtetin popullor, në lidhje me të sipërmit e me reaksionin grek e ndërkombëtar

Mbasi faji i tij parashikohet i ndëshkushëm prej Nen. evet 1 te Ligjit Nr.21 dat.15.12. 44, dhe 15 & II. te Ligjit Nr.41 D.14/I/1945.- është parë e nevojshëme që ky të gjykohet.

Prandaj:

Kërkoj gjykimin e tij nga ana e asaj Gjykate dhe mbasi t'i faktohet faji që akuzohet, në përfundim të vendoset ndëshkimi tij në bazë të Nen. 18 te Ligjit Nr.41.Dat.14.1.945, mbi Organizimin e fuksionimin e Gjykatave Usht.

Tirane më 10. VI. 1946

PROKURORI:
(Kap.I-re Nevzat Haznedari)
Nevzat Haznedari

Aktakuzë

INFORMACION

## Aktakuzë

Autoret: Nevzat Haznedari, prokuror

| | |
|---|---|
| DATA E KRIJIMIT | 10.6.1946 |
| FONDI | Hetimor-gjyqësor |
| NR. I FLETEVE | 1 |
| BURIMI | Arkivi AIDSSH |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

# Letër-rreshtim

MEDIA FAQE #1



Gjergj Kokoshi

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
PROKURORIJA E
GJYKATËS USHTARAKE E NALTE
Nr. 38 i R. P.

Vdekje Fashizmit - Liri Populli!

(2/1)

Letër-rreshtim
Kondra:

Gjergj Kokoshi bir' i Jaçim dhe i Viktore
vjeç 42 nga Shkodra-Tirane me profesion Profesor

Akuzohet

Si Armik i Popullit dhe Sabotater i Pushtetit.

Me qenë se faji i tij parashikohet prej Nenevet 1 te Ligjit Nr.21 date 15.XII.1944 dhe 15 parag.II te Ligjit Nr. 41 date 14.I.1945

Ne Prokuror' i Gjykatës Ushtarake në bazë të Nenit 20 parag.III te Ligjit Nr. 41.

Urdhërojmë:

Rreshtimin e tij për një kohë të pa caktuar në burgun e Tiranes

Organet e M. P., Policis dhe çdo fuqi e armatosur ngarkohet më zbatimin e këtij letër-rreshtimi.

PROKURORI
(Kap.I re Nevzat Haznedari)
Nevzat Haznedari

Tirane më 10.V.1946

KRYETARI
(Major Frederik Nosi)
F Nosi

MOD. 651

AIDSSH Nr. 67 Prot Date 29.01.2026

Letër-rreshtim

INFORMACION

## Letër-rreshtim

Autoret: Kap. I Nevzat Haznedari; Major Frederik Nosi,

| | |
|---|---|
| DATA E KRIJIMIT | 10.5.1946 |
| NUMRI I FAQEVE | 1 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

# Biografi

MEDIA FAQE #1



3068

11

REALACJON MBI GJERGJ KOKOSHIN

Gjergj Kokoshi,Ësht nga Shkodar dhe banues në Tiranë,me profesjon Arsimtar(Profesor),ka qen psjetar i Levizjes NAC.ÇLI.Gjat regjimit Anti-Popullor, të Zogut ka qen kundershtar i ketij regjimi.Prej kendej del se Gjergj Kokoshi,ësht nji element avnturjer i Poletikes,ambicjoz dhe se qellimi i tij qendron Anti-Popullorë.

Aji njihet mir si nji politikan i tillë(Aventurjer) dhe kete e ka faktuar me veprimtarin e tijë si në kohen e Zogut, si gjat okupacjonit ashtu dhe sot me Çlirimin e Shqipris dhe vumjen e Pushtetit në duart e Popullit.Aji ka patur nji farë simpathije në Popullë por me zbelimin e Organizates Klandestine të cilen aji e hudhheqte i humbi dhe aji pak kredi që kishte në Popullë,dhe Populli kuptoji se Gjergj Kokoshi,ishte nji vegel e të hujve të cilet dojshin që me anen e Gjergjit të rezojshin Pushtetin Popullorë dhe të bijshin në fuqi regjimet Anti-Popullore të më parshme.Gjergjei ka qen nji nga udhheqsit kryesor të Organizates klandestine të Sami Qeribashit,me shokë faktë ky që u vertetua përpara Gjyqit të Popullit.Gjergji ësht denuar nga Gjyqi i Popullit me 30 vjet burgim.

Përsonat në lidhje me të jan:

Sami Qeribashi,Shaban Balla,Ali Kavaja,Ivzi Golja,Tut Meniku, Mehmet Ali Beshiri,Xhait Koka,Talat Drini,e Qenan Dibra, të gjith keta të denuar me vdkje nga Gjyqi i Popullit,pse bashk me Gjergjin ishin Organizatoret e grupit klandestin për rezimin e Pushtetit Popullor;Mesine Kokolari,Suat Asllani,Kol Rodhe,Nefail Skikuli, Prof Çoka,Enver Hasa,Andon Dukagjini,Konstandin Kote, e tjer, ishin dhe keta udhheqsa kryesor të ketij grupi dhe kan mar vendime si mbas veprimatris Anti- Popullore që kan zhvilluar në lidhje me kete grup.Për veç ketyre u than ma nalt Gjergj Kokoshi,ka patur lidhje e dhe me elemnta të tjer të cilet sot ndodhen të lirë si me; Mirash Ivanaji,Ollga Plumbi,Shefqet Beja,[redacted],Visarjon-Xhuvani,Gaqo Opari,[redacted],Mustafa Çizmja,Besim Bogdani,Llambi Llambiti,[redacted].

Biografi

INFORMACION

## Biografi

| | |
|---|---|
| DOSJA | 1081.A.1 |
| FONDI | Hetimor-gjyqësor |
| DATA E KRIJIMIT | Pa datë |
| NR. I FLETEVE | 1 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

Dokument me 4 fletë

MEDIA FAQE #3



- 3 -

89

(k) Qeverija e ka humbu besimin e tregetarevet prej masavet qe ka marre kxxxar nder deget e ndryshme te aktivitetit ekonomik. Nisjativa private eshte shdukur pothua krejtesisht.

(I). Persa i perket politikes se jashteme, qeverija e tanishme i qendron besnike aksit Beograd-Moske. Parulla "Enver-Tito" eshte bere e zakoneshme.

3. CIL=T JEMI NE ,

Eshte nevoja te theksojme qe neve nuk jemi armiqte e komunizmit. Edhe sikur te mos egzistonte komunizmi do te qe e dobishme t'a krijonim si nje fuqi shtytese drejt perparimit social. Po nga ana tjeter ne jemi kundershteret e tija politike deri sa ay shkel lirite politike dhe ngre nje qeveri despotike ne vend te asaj demokratike.

4.-A ESHTE E MUNDUR DEMOKRACIJA NE SHQUPERI ?

Do te jete para kohe te behet fjale ne Shqiperi per nje demokraci te tipit perendimor. Po nga ana tjeter kjo nuk do te thote qe eshte nevoja per nje qeveri totalitare ne vendin t'one. Ne besojme se nje demokraci relative me te pakten 2 parti eshte plotesisht e mundeshme ne Shqiperi. Kjo gje do te jepte rast shumices se popullit te cilet nuk jane komuniste te bashkohen me nje organizate me anen e se ciles te jene ne gjendje te shprehin idete politike.

5. CILI ESHTE PROGRAMI YNE ?

(a) Politika e brendeshme.

Vendosja e menjehereshme e lirise se plote politike. Lirija e fese, liri shtypi, liri e personavet, kxxxjax dhe mbrojtja perpara ligjit dhe perpara gjyqit me gjykates te zgjedhur.

(b). Politika e jashteme.

Pjesemarrja ne te gjithe kombet e bashkuar ne themelimin e nje regulli internasional te bazuar mbi principin e sigurimit kolektiv. Mbajtja e relatavet miqsore me te gjithe aleatet t'one te medhenj dhe me te gjithe fqinjet t'are. Ne do te xxxxjxx perpiqemi me te gjitha forcat t'one per te dhene kontributin t'one per nje xxxxxxx te arthme paqesore dhe me te mirre ne ballkan, dhe te sigurojme integritetin t'one tokesor, konforme shpirtit dhe kartes se atllantikut.

(c) Politika sociale.

Permiresim materjal dhe moral i kxxxxxxx kondicavet te jetes te klases punetore. Pjesemarja e plote e punetorevet dhe e fshatarevet ne jeten politike. Lenija e lire e organizatave te punetorevet dhe pjesemarrja e tyre ne vendosjen e konditave te punes. Demokratizimi i instruksionevet. Rivendosja e dinjitetit familjer.

(d) Politika ekonomike.

Respektimi i plote i pasurise private brenda kufive te funksionave shoqerore. Kontroll i shtetit mbi industrite vitale dhe inkurajimi i nisjatives dhe i ndermarrjeve private.

Dokument me 4 fletë

MEDIA FAQE #4



-4-

90

Reforma agrare.

Ngritja e shtepijave moderne per fshtaresine dhe krijimi i kooperativave bujqesore.

6. Deshira e jone enxehte.

Duke konsideruar qe misjoni i juaj ne Shqiperi eshte i shenjte, pse e kini per detyre t'i thoni botes situaten e vertete te vendit t'one, shpresojme se do te konstatoni qe ne kxxx situaten e tanishme te flasesh per zgjedhje te lira do te thote te erresosh te verteten. Me kete fryme, ne shpresojme qe ju do te beheni interpret jo vetem i opozites po xxxxxgj pothuaj i deshires se te gjithe kombit per shtytjen e zgjedhjevet, ne menyre qe t'i jepet rast popullit te shprehe lirisht vullnetin e tija dhe ne kete menyre te xxxxxxx ngreje nje qeveri demokratike reprezentative.

Do te shifni nje numur te math realizimesh qe do t'ju tregohen per llogari te qeverise tanishme. Ne nuk veme ne dyshim vullnetin e mire te qeverise, por ne te njejten kohe e quajme te nevojshme te nenevizojme qe te shumtet e ketyre realizimevet kane egzistuar perpara Nentorit 1944. Persa u perket urravet dhe punimet te tjera te ketij lloji cdo Shqiptar e di mirre qe keto jane ndertuar prej shoqerive Italiane, nenen mbikqyrjen Shqiptare, me materjal qe eshte sjelle me pare prej Italija.

P.S. LUTEM SHDUKENI KETE RAPORT ME NJEHERE PORSA T'A KINI KENDUAR. NE QOFTE SE POLICIJA OSE CDO SPIUN DO TE MARRE VESH KETE GJE, JETA E JONE DO TE JETE NEREZIK.

Dokument me 4 fletë

INFORMACION

## Dokument me 4 fletë

| | |
|---|---|
| FONDI | 1 |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Hetimore-gjyqësore |
| DOSJA | 1081.A.1 |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Pa titull |
| NR. I FLETEVE | 4 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #6

# Procesverbal

MEDIA FAQE #1



---134---

një njeri fisnik të thotë kështu.

Prokurori: - Musine Kokalari me Musa Dizdarin janë duke mohuar fajet që kanë kryer dhe që botërisht dëshmitari po ua tregon. Por ne do t'ua vërtetojmë akoma më tepër me anë dëshmitarësh të tjerë.

Meret në pyetje i pandehuri G J E R G J   K O K O S H I, i cili, pas këndimit t'akuzës individuale, tha: " Nuk mund të përgjegjem për pa u formue një Komision i cili të hetojë nëse fajet që më ngarkon Sami Çeribashi janë të vërteta.

Prokurori:- Në qoftë se i pandehuri Gjergj Kokoshi kërkon të ndjekë gjurmat e Sami Çeribashit e te Musine Kokalarit për neve mjaftojne dokumentat për t'i dhene denimin e duhur. Përveç deponimevet të të pandehurvet ne proçeset e hetuësis kemi dhe deponimet e vetë të pandehurit Gjergj Kokoshit dhe ato të pandehurvet të tjerë bërë para Gjyqit; ay tha se ka dashur te ndihmoje familjen e kriminelavet te luftës.

Ju këndua proçesi i Prokuroris te cilin e vërtetoj.

Shaban Balla:- Në mbledhjen me Gjergj Kokoshin u foi për kriminelët e luftës.

Sami Çeribashi:- Folëm për kriminelët e luftës. Unë fola.Nuk di nëse dëgjoj ose jo Gjergj Kokoshi dhe s'mund të them se bëri ose jo kundërshtim.

Prokurori:- Mjafton që Gjergj Kokoshi e ka dijtur lidhjen me kriminelët e luftës.

AIDSSH Nr. 67 Prot. Date 29.01.2026

Procesverbal

INFORMACION

## Procesverbal

| | |
|---|---|
| FONDI | 1 |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Hetimore-gjyqësore |
| DOSJA | Nr. 1081.A.1 |
| FAQE | 134 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Kinema "Nacional", Tiranë |
| GJUHA | Shqip |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #7

# Dokument pa datë

MEDIA FAQE #1



227

Shqiptar për ( nuk kendohet )

Koha e zgjedhjeve afroi kur Kombi i jonè dò tè hyjè fell ndën kthedrat e Komunistava.

Popull Shqiptar.- Krenet e sotshem tradhetuen gjakunë e dëshmorve harren sakrificat e bamë prej teja, shkelen idealin per tè cillin u-ba lufta, sot nderne po sundon diktatura e hekurt e nji klike që ngrehu kulltuqet nè Tiranè mbi njeriun t'and dhe harroi vendimin që eshtè.

Popull Shqiptar.- A nuk shef me syt e tuej dallavet e ndryeshme që po luhen mbi kurrizin t'and tè keputun dhe mizerjet e shumëta qe tè kanè kapllue nden masken e kesaj Demokracije tè ndytè?

Popull Shqiptar.- Ku e ke sot nderin t'and, gjanè ma të shtrejtë dhe ma tè vlefsheme, per tè cillen dikur ishte kryelart ?

Ushtar .- E bijtè tè vendit, pas ardhesit e Skender-Beut, tè Naimit tè Vretos, tè Vaso Pashes, lufta e juej pse vjeçare per Shqiperi Demokratike u shkel. Shoket t'uej tè malit, ato qe fliteshin e shajshin burokracinè e teprueme, luksin, shpenzimet tè bame nè kurriz tè popullit, sot që zuen kulltuqet ju harruan, juve qe me gjakun e t'uej vaditet ç'do anè tè Shqiperisë.

Ndersa parja derdhet kot nder qejfe dhe vallzime, ndersa pallatet ku mbretenon lluksi dhe rahatija kalohen nè gezime, populli i djegun, katundar pa shtepi e voter, femija pa bukè, juve ju kanè strukun nder gazerma me nji copè bukè tè thatè.

Ku eshtè Drejtesija, ku eshtè fjala e dhanun, ku eshtè miqesija me Aleatet e Medhej. Po behen konferenca, mbledhje ku ato goditen.

Mbahen fjalime se neve do luftojmë kundra Anglo-Amerikanve. Ato qe tradhetuen se pari popullin, se dyti duen me tradhetue miqtè e Kombit t'onè, flamurtaret e Demokracive se vertetè.

Ku eshtè Kosova Shqipetare ? Kosova e Bajram Currit ? Ajo ju shi[t] Titos, dhe burrat e dheut u-masakruan dhe sot prej frike e tmerri po jetojnè nder male, luftojnè per Liri. Karta e Atllantikut u-shkel.

Koha e zgjedhjeve afroi/ Sabotoni. Bani Apozita. Mos votoni ku per njerzit e Frontit se ekzistenca e Shqiperise eshtè nè rrezik, si tha dhe radio Londra.

Ushtarè.- Sot qe populli vuen prej urije, sot qe ndihmat arrijnè e nuk shperndahen, sot qe burgjet qe perveç fajtorve janè mbushè dhe me tè pa fajshem.

Sot me shumë se kurrë
Asnji per votime
Asnji per Qeveri Komuniste
Asnji kundra Atdheut.
Tè gjithe per Liri Fjale, mendimi , apozitè. Per Demokraci.

Vllazen Shqiptar.-Sa do qe thonè Komunistat se qeverija na u-njotè, kejo nè pikepamje politike tè tyre nuk luen asnji rrol, mbassi kjo njoftje nga Aleatet t'onè eshtè bamë me qellim se njifet Shqiperija dhe jo Regjimi e me ketë rast eshtè njoftè administrata Provizore, kjo gja aspak nuk na deshperon, por na gezon se njifet para botes Atdheu i ynè, se ndryshe captohet prej Grekeve dhe Serbeve. Mos tuteni aspak kundrejt pallavrave tè tyre pse nuk munden me detyrue popullin me votue per keta.

Sot Nacionalizmi eshtè më tè naltè dhe eshtè perforcue ma shumë se kurrè, pse bota eshtè me ne dhe jo me rrebelat.

----------

Dokument pa datë

INFORMACION

## Dokument pa datë

| | |
|---|---|
| FONDI | 1 |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Hetimore-gjyqësore |
| DOSJA | 1081.A.1 |
| GJUHA | Shqip |
| DATA E KRIJIMIT | Pa datë |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #8

# Gjergj Kokoshi

MEDIA FAQE #1




Gjergj Kokoshi

MEDIA FAQE #2



Gjergj Kokoshi

INFORMACION

## Gjergj Kokoshi

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #9

# Gjergj Kokoshi

MEDIA FAQE #1



Gjergj Kokoshi

INFORMACION

## Gjergj Kokoshi

| | |
|---|---|
| FONDI | Hetimor-gjyqësor |
| DOSJA | 1081A.1 |
| BURIMI | AIDSSH |
| DATË | Pa datë |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.